



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 567/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rrustem Thaqi dhe faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Faton Xhaqkaj, duke vendosur lidhur me apelin e Anton Shala nga Gjakova, kandidat për deputet nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotim me nr.1712C/03D, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.03.2021, mori këtë

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.567/2021 e datës 04.03.2021, i paraqitur nga Anton Shala nga Gjakova, kandidat për deputet nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotim me nr.1712C/03D.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.03.2021, ka pranuar apelin Anr.567/2021 nga Anton Shala nga Gjakova, kandidat për deputet nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me të cilën pretendon se me rastin e marrjes së rezultateve në shkollën Filllore “Migjeni”, në Gllogjan Komuna e Pejës, në Qendrën e votimit 1712C/03D, në FRP, rezultojnë të jenë 27 (njëzet e shtatë) vota për nr.19, ndërsa nga të dhënat faktike nga vëzhguesi në këtë klasë, pretendon se janë të numëruara së paku 58 (pesëdhjetë e tetë) vota. Pretendon se është bërë gabim teknik ose i qëllimshëm nga Komisionarët, për faktin se kandidatja me nr.18 merr 27 (njëzet e shtatë) vota, ndërsa menjëherë pas vendosjen prapë 27(njëzet e shtatë) vota tek nr.19. parashtresuesi i apelit pretendon se mund të jenë përsëritur gabimisht numri i votave, 27 (njëzet e shtatë) për numrat 18 dhe 19. Si dëshmi ja ka bashkangjitur kopjen e formularit të vëzhguesit dhe deklaratën e Koordinatorit të Shkollës Filllore “Migjeni”, në Gllogjan Anton Antoni.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.03.2021, të KQZ-së, ndër të tjera thekson se Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palëve ankuese, në lidhje me ankesën Anr.567/2021, njofton se Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ka përfunduar procesin e punës si dhe futjen e të dhënave, skanimin e materialeve zgjedhore, verifikimi, hetimin, e formularëve të përputhjes së të dhënave dhe rezultateve, formularët e rezultateve, të kandidatëve FRK, procese këto që mundësojnë evitimin e çdo gabimi teknik dhe

jo relevant. Në bazë të Rregullës Zgjedhore, Nr.06/2013, secili formular i rezultateve, para se të filloj të procedohet, i nënshtrohet procesit të auditimit në QNR, gjatë të cilit proces krahasohen votat e subjekteve me votat e kandidatëve. Nga auditimi që i është bërë formularëve të rezultateve, rezulton se ka pasur probleme, të mos shënimit të saktë në kuptimin teknik të votave të subjekteve. Kur krahasohet me votat e kandidatëve, rezulton se kandidatët kanë vota, por subjekti nuk ka vota dhe ka raste kur subjekti ka vota ndërsa kandidatët nuk kanë vota. Procedura në QNR, nuk lejon asnjë Formular të kaloj, nëse nuk përputhet me votat e subjekteve me votat e kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota atëherë formulari nuk procedohet si i rregullt dhe shkon në auditim.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Kandidati për deputet Anton Shala, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, brenda afatit ligjor, ka parashtruar Apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që fletëvotimi 1712C/03D të rishqyrtohet dhe të konstatohet nëse ka parregullsi apo jo, sa i përket numrit të votave për kandidat.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur KQZ, me të cilën e ka refuzuar në tersi ankesën e ushtruar nga Anton Shala, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, duke konsideruar se ka përfunduar procesin e punës si dhe futjen e të dhënave, skanimin e materialeve zgjedhore, verifikimi, hetimin, e formularëve të përputhjes së të dhënave dhe rezultateve, formularët e rezultateve, të kandidatëve FRK, procese këto që mundësojnë evitimin e çdo gabimi teknik dhe jo relevant

Paneli, me rastin e vendosjes së apelit dhe përgjigjes në apel, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi.

PZAP, pas shqyrtimit të apelit Anr.567/2021, provave të bashkangjitura në apel, përgjigjes në ankesë dhe pas përfundimit të hetimit në QNR, erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Anton Shala, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është i pa bazuar.

Ekipi hetues, i formuar nga ana e PZAP-së, pas hetimit në QNR, ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i ankuesit, se të njëjtit nuk i janë numëruar votat për kandidat. Në kutinë e vendvotim me nr.1712C/03D, ekipi hetues ka gjetur se Anton Shala kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ka gjithsej 26 (njëzet e gjashtë) vota të vlefshme nga gjithsej 109 (njëqind e nëntë) vota të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Nga hetimi i bërë nga ana e PZAP-së, shihet qartë se pretendimi i ankuesit është tërësisht i pabazuar, për faktin se kandidati në fjalë ka gjithsej 26 (njëzet e gjashtë) vota dhe jo

ashtu siç pretendon ai se ka 58 (pesëdhjetë e tetë) vota, andaj si i tillë është refuzuar si pa bazuar.

PZAP, e shqyrtoi edhe deklaratën e Koordinatorit të Shkollës Filllore "Migjeni", në Glllogjan, të Pejës, Anton Antoni, me të cilën ka theksuar se nga rezultati përfundimtar i ka pasur të gjitha rezultatet, duke konstatuar se kandidati me nr.19 i ka gjithsej 58 (pesëdhjetë e tetë) vota, mirëpo këtë konstatim paneli e refuzoi tërësisht të pa bazuar dhe në kundërshtim me gjendjen faktike e cila gjendet në vendvotimin nr.1712C/03D, i hetuar nga ana PZAP-së, ku në të njëjtin vendvotim kanë rezultuar të jenë 26 vota.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 567/2021 më datën 05.03.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.